

Nr. 193/18
Data 15.10.18

TERMOKOS
NDËRMARRJA PUBLIKE-PUBLIC ENTERPRISE-JAVNO PREDUZEĆE
PRISHTINË-PRISHTINA-PRISTINA

KEK
KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS Sh.A.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KÖRPORACIJA KOSOVA D.D.

Nr. 1194 dt. 17.10 2018

16-10-2018
Nr. 7064
PRISHTINË-A

Amendamentimi i marrëveshjes për furnizim me ngrohje e dt 24.12.2014, nr. 252.

Ky Amendamentim është bërë në mes të Korporatës Energjetike të Kosovës Sh.A dhe N.P. Termokos Sh.A. për furnizim me ngrohje e dt 24.12.2014, nr. 252 (sipas referencës se KEK-ut) dhe bazuar në kërkesën e Termokos Sh.A. te dt. 03.09.2018 për vazhdimin e kohëzgjatjes së marrëveshjes në fjalë, sipas nenit 2.1 (a) aty.

Andaj, palët në marrëveshje, bien dakord si në vijim:

Neni 1:

Në pajtim me nenin 2. 1 të marrëveshjes, kjo marrëveshje zgjatet për periudhën e ardhshme 5 (pesë) vjeçare deri në fillimin e sezonit zyrtar të ngrohjes 2022, (sipas referencës aktuale 15 tetor 2022), me efekt nga data e skadimit të marrëveshjes bazë.

Neni 2:

SHTOJCA 4 e Marrëveshjes bazë "Ngarkesat për sasinë e furnizuar të ngrohjes, ngarkesat për kapacitetin e ngrohjes", zëvendësohet në tërësi nga

- Ngarkesa për Energji Elektrike (ETC) do të përcaktohet sipas eterike në pajtim me - Vendimit V_632_2014 të datës 16 Maj 2014 për aprovimin e çmimit të Rregulluar që do të zbatohen nga operatori i licencuar për Termocentralin Kosova A dhe Kosova B (Gjeneratorët e Rregulluar) i aprovuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë për vitin relevant tarifor.), si dhe
- Ngarkesa për Kapacitet të Energjisë Elektrike (ECCT) do të përcaktohet sipas Vendimit V_632_2014 të datës 16 Maj 2014 për aprovimin e çmimit të Rregulluar që do të zbatohen nga operatori i licencuar për Termocentralin Kosova A dhe Kosova B (Gjeneratorët e Rregulluar) i aprovuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë për vitin relevant tarifor).

Zëvendësohet në tërësi në

- Ngarkesa për Energji Elektrike (ETC) do të përcaktohet në bazë të marrëveshjes së arritur mes palëve KEK dhe TERMOKOS duke iu referuar çmimit të Furnizuesit të Shërbimit Universal (SHFU apo USS). Çmimi do të jetë subjekt i negocimit në baza vjetore. si dhe

- Ngarkesa për Kapacitet të Energjisë Elektrike (ECCT) do të përcaktohet në bazë të marrëveshjes së arritur mes palëve KEK dhe TERMOKOS duke iu referuar çmimit të ShFU. Çmimi do të jetë subjekt i negocimit në baza vjetore.

Neni 3:

Ky Amendament nuk rregullon çmimin e energjisë termike dhe Palët pajtohen që kjo të rregullohet në baza vjetore përmes një Aneks-marrëveshje pas çdo ndryshimi të çmimit të ShFU apo USS.

Neni 4:

Të gjitha kushtet tjera të Marrëveshjes bazë mbesin të pandryshuara dhe në fuqi.

Ky amendamentim hartohet në tri (3) kopje. Çdo palë pranon nga një (1) kopje dhe një kopje i dorëzohet ZRRE-së.

Në praninë e njëra tjetrës, palët ekzekutojnë këtë amendament të marrëveshjes, me datë, 16.10.2018

N.P. Termokos Sh.A
nga




Naser Canolli
Kryeshf Ekzekutiv

KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS sh.a




Njazi Thaçi
U.D Drejtor Menaxhues